



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA LEZHË  
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 10542 Prot.

Lezhë, më 01 . 06 . 2021

VENDIM

Nr. 99 Datë 28 . 05 . 2021

**Për përdorim të fondit të emergjencës për mbulimin e qirasë së banesave për 4 familje.**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”; të ligjit nr.68, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; të ligjit nr.45/2019 “Për Mbrojtjen Civile”, të Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”; dhe bazuar në vendimin e K.Bashkiak nr.87, datë 30.04.2021 “Për miratimin e subvencionimit të qirasë për familjet e prekura nga rrëshqitjet e dheut në Njësinë Administrative Ungrej dhe lagjen e Spitalit”; me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë;

**Vendosi :**

1.Miratimin e përdorimit të fondit të emergjencës në shumën 640,200 lekë për mbulimin e shpenzimeve të qirasë për 4 familjet e prekura nga rrëshqitja e dheut.

Për këtë bëhen këto ndryshime në programet buxhetore si më poshtë;

a.Pakësohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.602 në shumën 640,200 lekë, me emërtim: “Ndërhyrje emergjente”.

b.Shtohet: Gr.00, Prog.03280, Kap.05, Art./llog.ek.606 në shumën 640,200 lekë me emërtim: “Bonus qiraje për familjet”.

2.Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.

3.Ky vendim hyn fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETARI

FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI

ERNEST RAKAJ

